

VENDIM
Nr. 89, datë 29.6.2012

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE NË MASËN 100%
NGA KOMPANIA “HEC LANABREGAS” TE SUBJEKTI “UJËSJELLËS-KANALIZIME” SHA
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a., “Hec Lanabregas” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1 dhe 2” sh.a., vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 717, datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., të zotëruara nga METE, shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë., nenit 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe të nenit 5.3 të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve në masën 100% nga shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a. te subjekti “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Transaksioni i shitjes së aksioneve nga shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a., te subjekti “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë, është realizuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 717 datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., të zotëruara nga METE shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

- Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur është nënshkruar në datën 8.5.2012 dhe kontrata e shitjes me nr. 1588 Rep. dhe nr. 320/1 Kol. nga METE dhe subjekti “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

- Kontrata e nënshkruar nga palët ka në objekt transferimin e të drejtës së pronësisë dhe çdo të drejtë që lidhet me to nga shitësi “Hec Lanabregas” te blerësi “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

Për të gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e pronësisë së aksioneve në masën 100% nga kompania “Hec Lanabregas” te subjekti “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani